

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit E.K. nga fshati N., komuna e D., për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.2 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga i dënuari E.K., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.192/2016 datë 19.05.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.355/2017 datë 21.09.2017, në seancën e kolegjit e mbajtur më 26 mars 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit E.K., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.192/2016 datë 19.05.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.355/2017 datë 21.09.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.192/2016 datë 19.05.2017, i dënuari E.K. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPK-së, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit në pajtim me dispozitën e nenit 47 të KPRK i është zëvendësuar

në dënim me gjobë në lartësi prej 2500 (dymijë pesëqind) euro të cilën shumë i dënuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë apo nuk mundet ta paguaj, dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 € të gjobës do ti caktohet një ditë burgim. Të dënuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës së policit në Policinë e Kosovës në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve duke llogaritur prej datës kur aktgjykimi merr formë të prerë. Të dënuarit i konfiskohet kartëmonedha prej 50 euro. I dënuari obligohet që ti paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 100 € gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.355/2017 të datës 21.09.2017, me aprovimin e pjesshëm të ankesës së mbrojtësit të dënuarit E.K., dhe sipas detyrës zyrtare ka ndryshuar aktgjykimin përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, ashtu që ka gjetur se në veprimet e të dënuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK, si dhe i hiqet masa e ndalimit të profesionit në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet, konform nenit 65 par.2 të KPRK. Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesa e mbrojtësit të dënuarit për bazat tjera ankimore janë refuzuar si të pabazuara, ndërsa aktgjykimi në pjesën tjetër është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari E.K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.3 të KPPK, me propozim që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të aprovohet në tërësi si e bazuar kurse aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza, ose që të njëjtat të anulohen dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokurori i shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.244/2017 të datës 28.12.2017, ka paraqitur përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë i dënuari pretendon se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk kanë arrit ta vërtetojnë faktin kryesor e që ka të bëjë me gabimin në person, nuk kanë arrit të i heqin dilemat në lidhje me përgjegjësin penale të dënuarit dhe faktin se a ka qenë ai personi për të cilin deklaroi i dëmtuari i cili në asnjë fazë të procedurës nuk ka qenë i sigurt në njohjen e tij. Më tej në kërkesë pretendohet se shkeljet kanë të bëjnë me faktin se gjykata edhe përkundër mëdyshjeve lidhur me faktet vendimtare të njëjtat i ka interpretuar në dëm të dënuarit. Vendimi nuk është i mbështetur në rezultatin e dalë nga provat në mënyrë që të vërtetohet fakti kryesor identiteti i personit të dyshuar sepse ai nuk është kryesi i veprës . Pastaj në kërkesë pretendohet se fakti që ka mbet i pa vërtetuar e që esencialisht ndikon në rrjedhën e procedurës është data, koha kur është kryer veprimi i përshkruar në aktakuzë sepse nuk mund të vërtetohet a është data 1,2 apo 3 e muajit gusht 2016.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e të dënuarit janë të pabazuara, meqë aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal .

Kështu në këtë çështje penalo juridike, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka konstatuar se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara, ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse dhe arsyet me të cilat është udhëhequr me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale. Gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyet ligjore në të cilat është bazuar me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të dënuarit.

Kontestuese sipas të dënuarit ka qenë se gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nuk e kanë vërtetuar drejtë kohën e kryerjes së veprimit dhe nuk e kanë bërë drejt identifikimin e kryesit të veprës penale.

Nga të gjitha shkresat e lëndës dhe dispozitivi i aktgjykimi të kundërshtuar rezulton si jo kontestuese se me të gjitha provat e administruara, si dhe nga dëgjimi i dëshmitarëve është

vërtetuar se **koha kur është kryer veprimi i përshkruar në aktakuzë, është data 02. 08.2016** , e jo siç pretendon i dënuari se kjo kohë nuk ka mundur të vërtetohet. Gjithashtu rezulton si jo kontestuese se i dëmtuari I.Xh., ishte duke udhëtuar në autostradën “Ibrahim Rugova” në drejtim të Prishtinës me veturën e tipit 2BMV” me targa ..-... , ditën kritike është ndalur nga një patrullë e policisë në të cilën patrullë ka qenë dëshmitari Z.A., duke e bërë matjen me radar, kurse i dënuari E.K., duke bërë ndaljen e veturave, e ka ndalur të dëmtuarin I., e ka njoftuar për arsyet e ndaljes së tij duke i thënë se shpejtësia e lejuar është 100 km/h, kurse i dënuari ka drejtuar automjetin në shpejtësi prej 163 km/h, se për këtë kundërvajtje duhet ti shqiptohet dënim prej 95 €, por po të lehtësoj dhe po ta bëjë 60 €, të cilin duhet me paguar në postë, të njëjtin e pyet se a e njeh Prizrenin, pasi i dëmtuari thotë se nuk e njeh Prizrenin, i dënuari i thotë 50 euro dhe duke e kushtëzuar me marrjen e dokumenteve dhe me dërgimin e lëndës në gjykatë. Në këto rrethana i dëmtuari është detyruar t’ia jep 50 € pastaj ka vazhduar rrugën deri në Malishevë, ku në stacionin policor në Malishevë e lajmëron rastin.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i paraqitur lidhur me këto gjetjet e veta, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Arsyet të cilat i ka dhënë gjykata e shkallës së parë, kanë mbështetje në provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, dhe atë në deklaratat e dëshmitarëve Z.A., A.G. dhe Sh.D., në procesverbalin mbi mundësinë hetuese të veçantë mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit I.Gj. dhe në provat materiale. Nga dëshmitë e të dëmtuarit I.Gj., të dëshmitarëve të lartcekur, si dhe nga provat tjera materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor drejtë është vërtetuar se i dënuari në cilësi të personit zyrtar-policit ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, e kjo më së miri është vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarit, i cili në tërësi e ka përshkruar, kohën vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale nga i dënuari. Edhe me dëshminë e dëshmitarit Z.A., i cili ditën kritike ka qenë së bashku me të dënuarin E.K., është vërtetuar se ai ditën kritike ka qenë në patrullë me të dënuarin E., me të njëjtin kanë patrulluar në autostradën “Ibrahim Rugova”, kanë qenë prezent në pikën e kontrollit në kilometrin e dhjetë në drejtim të Vërmicë-Prishtinë, ku edhe kanë ndalur automjete të ndryshme se janë takuar me inspektorin e IPK në një pompë të benzinës ku ka qenë edhe i dëmtuari dhe dy zyrtarët policorë- A.G. dhe Sh.D. dhe një zyrtar i IPK, në pompën e benzinës ku kanë qenë duke ngrënë i dënuari E. dhe dëshmitari Z.A., i dëmtuari e ka identifikuar menjëherë policin Z.A. duke thënë se ky ka qenë në pikën e kontrollit në vendin e ngjarjes me radar, **gjithashtu ka identifikuar edhe të**

dënuarin E.K., prandaj sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i të dënuarit përkitazi me këtë se dy gjykatat kanë gabuar përkitazi me identifikimin e personit, është i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoj se aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkeljen e ligjit penal dhe shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Pml.nr.279/2017, më 26 mars 2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Emine Mustafa